

STATUTI I SHOQATËS “BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTAR”

Ky dokument do të jetë Statuti i organizatës në formën e shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar” (në vijim: “Shoqata”), dhe do të rregullojë qëllimin, organet, asetet, mënyrën si përdoren të ardhurat dhe burimet e financimit të Shoqatës.

Shoqata është themeluar dhe krijuar si një organizatë jo-fitimprurëse, në formën e shoqatës me të drejtën e anëtarësimit në përputhje me Ligjin nr. 7850, datë 27.09.1994 “Kodi Civil Shqiptar”, i ndryshuar dhe Ligjin nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jo-Fitimprurëse”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e një Organizate Jo-Fitimprurëse” nga themeluesit e mëposhtëm:

1. Luan Leka - EHW shpk
2. Donika Mici – Donianna shpk
3. Nikolin Jaka – AgroAl International shpk
4. Bardhyl Baltëza – Edipack sha
5. Ylli Braka – Klodi sha
6. Luan Muca – DAST (Delta Adhesive Structural Tech) sha
7. Stefan Pinguli – Stefani & Co sha
8. Vullnet Haka – Everest IE shpk
9. Ibrahim Myftaraj – GBE Herbs shpk
10. Lumir Osoja – Center Shqiptare shpk
11. Edmond Ziso – Aquila Group shpk

Në vijim referuar si “Themeluesit”, të cilët miratojnë këtë Statut të shoqatës “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar”

NENI 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Ky Statut, që qeveris organizatën jo-fitimprurëse “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar”, do të rregullojë midis çështjeve të tjera, edhe çështjet në vijim:
- emrin, selinë dhe territorin e saj;
 - qëllimin, objektivat dhe veprimtarinë e saj;
 - zgjedhjen dhe procedurat për pranimin, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të saj;
 - organet qeverisëse, marrëdhënien midis organeve qeverisëse, autoritetet respektive, detyrimet dhe procedurat për emërimin dhe revokimin në këto organe, përgjegjësitë dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme, Bordit Drejtues dhe zyrtarëve të saj;
 - menaxhimin e asteve dhe përdorimin e fondeve të saj;
 - si dhe procedurat në rast të shpërndarjes së shoqatës.

NENI 2 - EMRI I SHOQATËS

- 2.1. Emri zyrtar i shoqatës është “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar”.
- 2.2. Stampa dhe vula zyrtare e shoqatës do të lexojnë “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar” në gjuhën shqipe.
- 2.3. Simboli i shoqatës është sipas modelit bashkëlidhur këtij statuti.

NENI 3 - SELIA E SHOQATËS

- 3.1. Selia e shoqatës është në adresën: Rruga e Kavajës, nr.6, Tirana, Shqipëri.
- 3.2. Shoqata, me anë të vendimit të Bordit Drejtues, mund të ndryshojë selinë apo të themelojë një seli operative në një vendodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë ose jashtë kufijëve të saj.

NENI 4 - ASETET DHE KAPITALI I SHOQATËS

- 4.1. Shoqata mund të jetë zotëruesja e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, një pasuri e kufizuar vetëm për qëllimet e shoqatës. Asetet e Shoqatës mund të përfshijnë të gjithë pasuritë e tundshme dhe të ardhurat të krijuara nga donacionet, kontributet, nga organizimi i konferencave, seminareve dhe ngjarjeve, dhe nga çdo e ardhur tjetër e krijuar në përputhje me këtë Statut dhe në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi; burimet e themeluesve (kuotat e anëtarësisë); grantet, donacionet dhe kontributet nga personat juridike dhe/apo personat fizikë; burimet që mund të fitojë si zotëruese e asteve të saj, të tilla si të drejtat e pronësisë intelektuale apo industriale apo si burime të tjera të lejuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi për organizatat jo-fitimprurëse.
- 4.2. Fondet e Shoqatës apo çdo e ardhur si rezultat i veprimtarisë ekonomike të Shoqatës mund të përdoren vetëm për zbatimin e qëllimeve të Shoqatës dhe për operimin e saj dhe nuk do të përdoren për të siguruar përfitime apo për të gjeneruar të ardhura, në mënyrë direkte apo indirekte, nga cdo themelues, administrator, drejtor, anëtar, agjent, punonjës apo donator, përvec se pagave/pagesave ndaj personave të punësuar në Shoqatë apo furnitorëve.
- 4.3. Kuota e Anëtarësisë vendoset çdo vit nga Bordi Drejtues.
- 4.4. Fondet dhe asetet e fituara nga donatorët për një objekt/qëllim specifik, duhet të përdoren vetëm për atë destinacion. Marrëdhënia ndërmjet donatorëve dhe Shoqatës duhet të krijohet/përkufizohet në marrëveshje respektive.

- 4.5. Shoqata do të jetë përgjegjëse për detyrimet e saj vetëm nëpërmjet asetëve të saj dhe Shoqata dhe/ose zyrtarët e saj nuk do të jenë përgjegjës kundrejt palëve të treta, vetëm në rast se kanë shkaktuar dëme palëve të treta për shkak të neglizhencës së madhe dhe lajthitjes së qëllimshme nga ana e tyre gjatë detyrave në punë, në përputhje me nenin 25, të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jo-Fitimprurëse”.

NENI 5 - PARIMET E SHOQATËS

- 5.1. Shoqata është një organizatë jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, e themeluar nga anëtarët themelues të përcaktuar në nenin 9.2, të këtij Statuti. Shoqata ka për qëllim të përfaqësojë, të mbrojë dhe të përmirësojë interesin e përbashkët të prodhuesve shqiptarë që operojnë në Republikën e Shqipërisë.
- 5.2. Organi më i lartë vendimarrës i Shoqatës është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës në formën e Asamblesë së Përgjithshme (në vijim, “Asambleja”).
- 5.3. Bordi Drejtues (në vijim, “Bordi”) i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme do të zbatohet dhe do të mbikqyrë veprimtarinë e përgjithshme të Shoqatës në përputhje me ligjet në fuqi dhe në përputhje me këtë Statut.
- 5.4. Shoqata do të ketë një Sekretar të Përgjithshëm, të zgjedhur nga Bordi Drejtues, i cili është përgjegjës për të garantuar zbatimin e statutit, organizimin e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordit Drejtues, komunikimin e efektshëm ndërmjet anëtarëve të Bordit Drejtues, ndërmjet Bordit Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme dhe ndërmjet Shoqatës dhe palëve të treta, marrëdhënia me të cilët është në dobi të shoqatës (pushteti qendror/lokal, institucionet publike të pavarura, organizatat e sipërmarrjes, media si dhe organizatave apo entiteteve jashtë vendit).
- 5.5. Shoqata do të ketë një Drejtor Ekzekutiv të emëruar nga Bordi Drejtues, i cili është përgjegjës për operimin dhe menaxhimin ditor të shoqatës, sipas funksioneve dhe detyrave të deleguar atij/asaj nga Bordi Drejtues.
- 5.6. Shoqata do të krijojë disa Komitete për çështjet më të rëndësishme të cilat do të marrin në analizë dhe do të pregatisin propozime për tu miratuar në Bordin Drejtues. Çdo Komitet do të drejtohet nga njëri prej anëtarëve të Bordit ose nga ekspert i jashtëm i caktuar nga Bordi Drejtues dhe do të ndiqet nga Sekretari i Përgjithshëm / Drejtori Ekzekutiv.
- 5.7. Shoqata nuk do të angazhohet në veprimtari politike dhe fondet/asetet e saj nuk do të përdoren për qëllime politike.
- 5.8. Politikat dhe programet e Shoqatës do të jenë në një linjë me qëllimet dhe objektin e saj siç është përcaktuar në Nenin 6 dhe 8.

NENI 6 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQATËS

- 6.1. Objekti i Shoqatës është ti shërbejë anëtarëve të saj por edhe të gjithë sektorit të prodhimit vendas me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, nëpërmjet informimit të vazhdueshëm, mbështetjes në forma të ligjshme të sektorit të prodhimit, nxitjes së prodhimit vendas si dhe promovimit të anëtarëve të saj.
- 6.2. Veprimtaria e Shoqatës ka për qëllim që:
- a. të rrisë ndërgjegjësimin e prodhuesve për të qenë pjesë e këtij organizimi në dobi të tyre;
 - b. të kryejë kërkime mbi sektorin e prodhimit në Shqipëri dhe analiza krahasuese në lidhje me çështje që ndikojnë në këtë sektor;
 - c. t'ju ofrojë ndihmë profesionale dhe edukative anëtarëve të saj;
 - d. të ndihmojë në hartimin e një politikë kombëtare për prodhimin vendas;
 - e. të shpërndajë informacionin mbi prodhuesit dhe prodhimin;
 - f. të krijojë dhe të organizojë dhënien e çmimeve vlerësuese për prodhuesit apo prodhimet vendase;
 - g. të ofrojë këshilla mbi politikat publike dhe nismat ligjore për sektorin e prodhimit;
 - h. të ndihmojë në ndërtimin e një ndërgjegjësimi të gjerë në lidhje me Mbrojtjen e Konsumatorit, Përgjegjësinë Sociale të Korporatave, Konkurrencën e Ndershme, si dhe të çështjeve të tjera të lidhura ngushtë me prodhimin;
 - i. të ndihmojnë në rritjen e kapacitetit të prodhuesve në mënyrë që të integrojnë standartet më të mira dhe bashkëkohore të prodhimit;
 - j. të krijojnë marrëdhënie me Shoqata apo organizata të ngjashme jashtë Shqipërisë, në mënyrë që të bëhet pjesë e networkut ndërkombëtar të prodhuesve;
 - k. të bëjë edhe çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe në funksion të zhvillimit të shoqatës.
- 6.3. Shoqata do të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo do të udhëhiqet nga standartet më të mira etike duke adoptuar Kodin e saj të Etikës si dhe dokumenta të tjerë të rëndësishëm.
- 6.4. Në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe këtë Statut, Shoqata me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

NENI 7 - KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQATËS

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës është për një periudhë të pakufizuar.

NENI 8 - VEPRIMTARIA

- 8.1. Në mënyrë që të arrijë objektivat e saj të përcaktuar në Nenin 6 të këtij Statuti, Shoqata do të:
- a. krijojë dhe përditësojë vazhdimisht regjistrin e të gjithë prodhuesve shqiptare;
 - b. organizojë tryeza sektoriale dhe të veçanta për çështje të rëndësishme;
 - c. informojë në mënyrë të vazhdueshme anëtarët e saj, partnerët, grupet e interesit si dhe publikun e gjërë për veprimtarinë e saj duke aktivizuar kanalet e komunikimit nëpërmjet faqes së saj web dhe rrjeteve sociale;
 - d. kryejë një fushatë komunikimi kombëtar në lidhje me sektorin e prodhimit dhe rolin e prodhuesit dhe prodhimeve vendase;
 - e. kryejë çdo veprimtari tjetër në interes të shoqatës.

NENI 9 - ANËTARËT E SHOQATËS

9.1. Anëtarët e Shoqatës mund të jenë të gjithë subjekte juridike të regjistruar dhe që operojnë në Shqipëri në sektorin e prodhimit.

9.2. Anëtarët themelues të Shoqatës janë:

1. Luan Leka - EHW shpk
2. Donika Mici – Donianna shpk
3. Nikolin Jaka – AgroAl International shpk
4. Bardhyl Baltëza – Edipack sha
5. Ylli Braka – Klodi sha
6. Luan Muca – DAST (Delta Adhesive Structural Tech) sha
7. Stefan Pinguli – Stefani & Co sha
8. Vullnet Haka – Everest IE shpk
9. Ibrahim Myftaraj – GBE Herbs shpk
10. Lumir Osoja – Center Shqiptare shpk
11. Edmond Ziso – Aquila Group shpk

NENI 10 - ANËTARËSIMI NË SHOQATË

10.1. Anëtarësimi në shoqatë do të jetë vullnetar duke paguar një kuotizacion vjetor masa e të cilit miratohet nga Bordi Drejtues.

10.2. Subjektet e interesuara për tu anëtarësuar në Shoqatë duhet të dorëzojnë një aplikim anëtarësimi i cili duhet të shoqërohet nga dokumenti përkatës që provon parapagimin e kuotës së përcaktuar të anëtarësimit si edhe dokumentat e duhur mbi aplikantin. Kriteret dhe dokumentat e aplikimit për tu bërë anëtar i shoqatës miratohen nga Bordi Drejtues.

- 10.3. Cdo anëtar i Shoqatës duhet të nënshkruajë Kodet dhe Deklaratat e miratuara prej saj dhe të detyrueshme.
- 10.4. Cdo anëtar i ri do të marrë një Çertifikatë Anëtarësimi me bazë vjetore me anë të të cilit zyrtarisht njihet pranimi i tyre në Shoqatë.

NENI 11 - PËRJASHTIMI

- 11.1. Bordi mund të përjashtojë një Anëtar të Shoqatës për sjelljeje të pahijshme, dhe/apo për shkelje të dispozitave statutore të Shoqatës, dhe/apo nga-rregulloret e brendshme të Shoqatës apo për çdo arsye tjetër me kusht që ky perjashtim të jetë paraprirë nga:
- a) një hetim të plotë, i kryer nga Bordi i Drejtorëve në bazë të një vendimi të marrë për këtë qëllim prej tij e që provon çdo akuzë për sjellje të keqe apo të pahijshme;
 - b) një seance dëgjimore para Bordit të Drejtorëve që ti japë mundësi këtij Anëtari për të paraqitur pretendimet e tij/saj (nëse kjo kërkohet nga Anëtari në fjalë);
 - c) një votim me shumice të cilësuar të Bordit, përveç votës së anëtarit, nëse është edhe anëtar i Bordit, i propozuar për përjashtim, duke arritur në përfundimin se vijimi i anëtarësimi të këtij Anëtari mund të jetë i dëmshëm për Shoqatën.
- 11.2. Me tej, Bordi mund të vendosë për përjashtimin e një anëtari nëse ai/ajo nuk ka paguar detyrimet vjetore edhe pas njoftimeve të vazhdueshme nga shoqata.

NENI 12 - HEQJA DORË

- 12.1. Anëtari i Asamblesë së Përgjithshme mund të heqë dorë nga antarësimi në Shoqatë duke i dërguar njoftim paraprak me shkrim Presidentit jo më vonë se 1 muaj përpara aktit të dorëheqjes. Në këtë rast pagesat e kryera të kuotizacionit janë të pakthyeshme.

NENI 13 - FUNKSIONET E NDERIT

- 13.1. Funkcionet e Nderit të Shoqatës do të caktohen si të tilla nga votat unanime të Bordit Drejtues.
- 13.2. Funkcionet e Nderit nuk mund të jenë funksionet të zgjedhshme dhe nuk kanë të drejtë të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme dhe Bordin Drejtues të Shoqatës.
- 13.3. Funkcionet e Nderit nuk kanë detyrimin e pagesave të çfarëdolloj kuote, por me vendim Bordi mund të rimbursohen për shpenzime të kryera në dobi të veprimtarisë së shoqatës.

ORGANET, VENDIMARRJA DHE MENAXHIMI I SHOQATËS

NENI 14 - ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 14.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqatës, e cila merr vendime për veprimtarinë dhe politikën e Shoqatës. Mbledhja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë Anëtarët e Shoqatës.
- 14.2. Në cilësinë e organit më të lartë vendimarrës të Shoqatës, Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin të marrë vendime përfundimtare në lidhje me:
- a. miratimin dhe ndryshimin e Statutit të Shoqatës dhe Rregulloreve të saj;
 - b. miratimin e Programit Vjetor të Shoqatës dhe të buxhetit mbështetës, të financave dhe të shpenzimeve që do të kryhen;
 - c. strategjinë dhe prioritetet e Shoqatës;
 - d. shpërndarjen e Shoqatës;
 - e. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit Drejtues;
 - f. përcaktimin e kriterëve për investimin e aseteve të Shoqatës dhe miratimin e raportit vjetor;
 - g. monitorimin dhe mbikqyrjen e performancës së Bordit Drejtues lidhur me zbatimin e politikave dhe strategjive të Shoqatës;
 - h. çështje të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi apo çdo çështje tjetër lidhur me Shoqatën të cilat nuk përfshihen në mënyrë specifike në kompetencat e Bordit Drejtues apo të zyrtarëve të saj.

NENI 15 - MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 15.1. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet të paktën një herë në vit, por, në çdo rast brenda tremujorit të dytë të çdo viti kalendarik. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime nëpërmjet mbajtjes së një mbledhje ose me anë të marrjes së vendimeve në formë të shkruar, në çdo kohë që ajo e konsideron të nevojshme për interesin e Shoqatës.
- 15.2. Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Asamblesë mund të thirren me kërkesë të paraqitur nga të paktën 1/5 e anëtarëve të Shoqatës. Në çdo rast, kjo kërkesë duhet të paraqitet të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes të propozuar.
- 15.3. Pavarësisht nenit 15.2, të gjitha takimet e Asamblesë së Përgjithshme do të thirren nga Sekretari i Përgjithshëm. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në selinë e regjistruar të Shoqatës apo në çdo qytet apo shtet të botës që anëtarët mund të bien dakort.

- 15.4. Të gjithë anëtarët e Asamblesë duhet të njoftohen për mbledhjen, të paktën 30 ditë kalendarike përpara me shkrim, përfshirë mjetet elektronike.
- 15.5. Presidenti së bashku Sekretarin e Përgjithshëm, do të përgatitin rendin e ditës për çdo mbledhje të Asamblesë. Rendi ditës do t'ju dërgohet të gjithë anëtarëve jo më vonë se 10 ditë pune përpara mbledhjes së programuar. Çdo Anëtar mund të propozojë çështje për t'u shqyrtuar në mbledhjen e Asamblesë, me kusht që këto propozime janë bërë me shkrim e të jenë paraqitur jo më vonë se 5 ditë pune përpara ditës së takimit përkatës.
- 15.6. Të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm.
- 15.7. Pjesëmarrja e më shumë se 1/2 se anëtarëve të Shoqatës në takim do të përbëjë kuorumin e nevojshëm për vijimin e mbledhjeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.
- 15.8. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Statut, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë me shumicë të thjeshtë të votave të pranishme dhe me të drejtë vote.
- 15.9. Të gjithë Anëtarët kanë të drejtën e një vote.
- 15.10. Çdo Anëtar ka të drejtë të përfaqësohet me prokurë nga një person tjetër. Emri i personit, i cili do të përfaqësojë anëtarin, duhet t'i njoftohet me shkrim Presidentit jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë përpara mbledhjes përkatëse.
- 15.11. Anëtarët të cilët banojnë jashtë vendit apo e kanë të pamundur të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë, mund të votojnë mbi rendin e ditës përkatës me anë të postës apo mjeteve elektronike. Në rastet kur një Anëtar do të marrë pjesë në vendimarrje me shkrim, ai/ajo duhet të njoftojë paraprakisht Presidentin për mënyrën dhe mjetin e votimit. Përveç kësaj, Presidenti do t'i dorëzojë anëtarit përkatës vendimin e propozuar për tu marrë dhe dokumentacionin përkatës që plotëson vendimin, me anë të postës apo mjeteve elektronike të paktën 14 ditë pune përpara datës së caktuar. Anëtari do të miratojë vendimin dhe do e rikthejë atë brenda 7 ditëve nga data që vendimi me shkrim është dorëzuar Anëtarit.

NENI 16 - BORDI DREJTUES

- 16.1. Organi më i lartë ekzekutiv do të jetë Bordi Drejtues. Bordi do të përbëhet nga 15 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Numri i Anëtarëve të Bordit Drejtues mund të rritet ose zvogëlohet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, por në çdo rast numri i anëtarëve nuk duhet të jetë më pak se 3 dhe do të jetë numër tek. Nëse numri i anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme rritet me më shumë se 30%, kjo e fundit në mbledhjen e rradhës mund të votëbesojë Bordin

Drejtues aktual ose të kërkojë fillimin e procedurave për zgjedhje të reja në Bordin Drejtues.

- 16.2. Bordi është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit dhe ndjekjes së programeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme. Bordi do të kryejë të gjithë veprimtaritë e Shoqatës të cilat nuk janë të dhënë në mënyrë specifike ndonjë organi tjetër të parashikuar në këtë Statut. Në mënyrë të veçantë, Bordi do të jetë përgjegjës për:
- a. rekomandimin e ndryshimeve të këtij Statuti të Shoqatës;
 - b. ndjekjen e zbatimit të politikave dhe strategjive të Shoqatës të miratuara nga Mbledhja e Përgjithshme;
 - c. thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, në rastet e parashikuara në këtë Statut;
 - d. miratimin e strukturës dhe organikës së Shoqatës;
 - e. zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe emërimin e Drejtorit Ekzekutiv;
 - f. përgatitjen e Programit Vjetor të Shoqatës, sëbashku me një buxhet mbështetës dhe t’ja paraqesë atë Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - g. raportimin në Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave dhe strategjive të Shoqatës;
 - h. të vendosë për kriteret specifike dhe procedurat e anëtarësimit;
 - i. miratimin e anëtarësimit në shoqata dhe organizata të tjera;
 - j. hapjen dhe mbylljen e degëve të Shoqatës;
 - k. caktimin e likuidatorit;
 - l. bashkimin me ndonjë OJF tjetër;
 - m. kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara nga ligji apo nga Asambleja e Përgjithshme kohë pas kohe;
- 16.3. Bordi Drejtues ka të drejtë të krijojë komitete (ose grupe të posaçme), të nevojshme për funksionimin efektiv e të suksesshëm të Shoqatës. Bordi do të jetë përgjegjës për hartimin dhe/apo përcaktimin e emërtesës, formës, objektivave, dhe për miratimin e kompetencave të këtyre komiteteve. Bordi zgjedh kryetarin që do të drejtojë secilin komitet që ajo krijon.
- 16.4. Anëtari i Bordi Drejtues për të kandiduar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
- a. të jetë anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të shoqatës;
 - b. sipërmarrës prodhues ose përfaqësues i deleguar nga sipërmarrja prodhuese;
 - c. të mos ketë qenë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë, vërtetuar me dëshmi penaliteti;
- 16.5. Bordi Drejtues ka të drejtën t’i propozojë Asamblesë së Përgjithshme, politika shtesë për Shoqatën, si edhe t’i rekomandojë ndryshime të këtij Statut dhe ti paraqesë ato për miratim tek Asambleja e Përgjithshme.

- 16.6. Bordi do të përgatisë dhe do të dorëzojë raporte mbi zbatimin e politikave dhe strategjive të Shoqatës në Asamblenë e Përgjithshme të paktën 1 herë në vit.
- 16.7. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën që me anë të një vendimi të marrë me shkrim, të përfundojë mandatin për çdo anëtar apo të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues. Çdo anëtar i Bordit Drejtues mund të paralajmërohet/shkarkohet nëse ai apo ajo abuzon me autoritetin e tij/saj apo nëse nuk përmbush funksionet e tij/saj si anëtar i Bordit, me kusht që një veprim i tillë të mbështetet nga një vendim i shkruar dhe me votim të fshehtë të 2/3 të anëtarëve të pranishëm dhe me të drejtë vote në mbledhjet e zakonshme apo të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.8. Çdo Anëtar Bordi që dëshiron të japë dorëheqjen nga Bordi do të njoftojë Presidentin me shkrim për këtë qëllim. Mbasi dorëheqja të jetë pranuar, pozicioni i anëtarit respektiv të Bordit do të mbetet vakant. Nëse Presidenti ka për qëllim të japë dorëheqje nga Bordi, atëherë ai/ajo duhet të njoftojë me shkrim Bordin Drejtues.
- 16.9. Në rast vdekje, dorëheqje, largimi apo përjashtimi të çdo Anëtari të Bordit, pasardhësi që do të zërë pozicionin vakant, do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se numri i anëtarëve të Bordit bie nën minimumin e lejuar sipas këtij Statuti, Anëtarët e mbetur të Bordit do të plotësojnë pozicionin vakant përkohësisht deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme e cila do të miratojë anëtarët e caktuar përkohësisht nga Bordi ose do të caktojë anëtarë të rinj.
- 16.10. Anëtarët e Bordit nuk shpërblehen, megjithatë nuk përjashtohen nga e drejta për tu rimbursuar për çdo shpenzim plotësisht të justifikuar të kryer gjatë mandatit të anëtarit.
- 16.11. Anëtarët e Bordit duhet t'i kryejnë detyrat e tyre të parashikuara nga ligji ose ky Statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqatës në tërësi, e cila përfshin edhe parimet e qëndrueshmërisë mjedisore.

NENI 17 – ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË BORDIT

- 17.1. Votimi për zgjedhjen e Anëtarëve të Bordit do të kryhet nëpërmjet votimit me shkrim në mënyrë të fshehtë të anëtarëve të propozuar nga anëtarë të tjerë të Shoqatës sipas parimit një anëtar një votë.
- 17.2. Kandidati për anëtar në Bordin Drejtues duhet të propozohet nga 3 anëtarë të asamblesë (një anëtar nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat);
- 17.3. Kandidatët që marrin numrin më të lartë të votave nga Asambleja e Përgjithshme do të deklarohen anëtarë të Bordit.

- 17.4. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjat për një periudhe kohë të llogaritur në bazë të ½ numrit të anëtarëve.
- 17.5. Propozimet për pozicione të reja ose vakante në Bordin Drejtues duhet t'i dorëzohen Presidentit nga çdo Anëtar i Shoqatës menjëherë sapo të shpallen vendet vakante. Propozimet duhet të dorëzohen me shkrim të paktën shtatë (7) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 18 - PRESIDENTI, SEKRETARI PËRGJITHSHËM DHE DREJTORI EKZEKUTIV

- 18.1. Presidenti perfaqëson Shoqatën kundrejt palëve të treta. (i cili është në të njëjtën kohë Kryetari i Bordit, në vijim referuar si "Presidenti"); Presidenti i parë do të zgjidhet nga Bordi Drejtues dhe do të ndryshojë çdo 6 muaj me rrotacion sipas rendit alfabetik të emrave të anëtarëve të saj. Kur anëtari i rradhës heq dorë nga marrja e mandatit të Presidentit, ai mund të propozojë zgjatjen e mandatit të Presidentit aktual ose t'ja kalojë mandatin e tij një kandidati tjetër.
- 18.2. Presidenti do të drejtojë të gjitha mbledhjet e Bordit. Në rast mungese të tij, ai mund të delegojë drejtimin e mbledhjes njërit prej Zëvendës Presidenteve.
- 18.3. Bordi Drejtues zgjedh në mbledhjen e parë Zëvendës Presidentet e Shoqatës për një mandat 6 mujor. Ato kryejnë detyrat dhe funksionet e përcaktuara nga Bordi Drejtues ose ato të deleguara nga Presidenti. Në rast se Presidenti i Shoqatës jep dorëheqje, hiqet, apo në një mënyrë nuk përmbush detyrat e tij/saj si President, njëri nga Zëvendës Presidentet do ta zëvendësojë atë dhe në këtë mënyrë do të marrë titullin dhe përgjegjësitë e Presidentit, deri në kohën që të zgjidhet Presidenti i ri nga Bordi Drejtues.
- 18.4. Bordi Drejtues zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm me shumicë të thjeshtë të votave. Sekretari i Përgjithshëm do të ketë detyrën të mbikqyrë dhe monitorojë me përgjegjshmëri në mënyrë që të sigurojë zbatimin e statutit, organizon mbledhjet e Asamblesë dhe Bordit Drejtues, siguron komunikimin e efektshëm ndërmjet anëtarëve të Bordit, ndërmjet Bordit dhe Asamblesë së Përgjithshme dhe ndërmjet Shoqatës dhe palëve të treta (parlamenti, ekzekutivi, organizatat e sipërmarrjes, media si dhe organizatave apo entiteteve jashtë vendit), si dhe të drejta e detyra lidhur me veprimtarinë dhe menaxhimin e Shoqatës të deleguara dhe caktuara nga Presidenti apo Bordi Drejtues.
- 18.5. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Bordi Drejtues dhe do të mbajë përgjegjësi primare për përdorimin e të gjitha fondet e mbledhura në formë të ardhurash si dhe për shpenzimet e operimit të Shoqatës. Ai është përgjegjës për operimin dhe menaxhimin ditor të Shoqatës, sipas funksioneve dhe detyrave të deleguar atij/asaj nga Bordi Drejtues. Drejtorit në çdo kohë mund t'i kërkohet nga Presidenti t'i sigurojë atij/asaj

raporte financiare për rishikim dhe referim të mundshëm në Bord.

18.6. Funkcionet e para të zgjedhura do të jenë:

- Luan Leka - President
- Donika Mici - Zëvendës President
- Bardhyl Baltëza - Zëvendës President
- Arben Shkodra - Sekretar i Përgjithshëm

Gjithashtu, Arben Shkodra do të mbulojë përkohësisht pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv deri në emërimin perfundimtar të tij nga Bordi Drejtues.

NENI 19 - MBLEDHJET E BORDIT

19.1. Mbledhjet e Bordit do të thirren nga Presidenti me njoftim me shkrim, përfshirë dhe mjetet elektronike, dhe do ju dërgohet secilit anëtar të Bordit jo më vonë se 10 ditë pune përpara datës së mbledhjes përkatëse.

19.2. Mbledhjet e Bordit mund të thirren edhe nga 1/3 e anëtarëve të saj. Në këtë rast, ata duhet të njoftojnë me shkrim anëtarët e tjerë të Bordit të paktën 10 ditë përpara, duke specifikuar arsyet dhe rendin e ditës për këtë mbledhje.

19.3. Bordi i konsideron vendimet e vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se ½ e anëtarëve të saj ("kuorumi"). Kuorumi i arritur si rezultat i votave të përfaqësuarve me prokurë është i vlefshëm vetëm për marrjen e vendimeve për çështjet e përcaktuar me prokurë.

19.4. Bordi do të zbatojë vendimet që mbështeten nga shumica e votave të anëtarëve të tij.

19.5. Bordi i Drejtorëve mund të vendos gjithashtu me anë të vendimit të shkruar, telefonit apo mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, përveç se në rastet kur të paktën një nga anëtarët kundërshton këtë formë vendimarrje. Vendimi i propozuar sëbashku me dokumentacionin që plotëson vendimin do t'ju dërgohen anëtarëve të Bordit me anë të postës ose me mjete elektronike. Anëtari/ët do të vendosin për vendimin brenda 4 ditëve që nga data që vendimi me shkrim ju është dërguar atyre. Anëtari/ët e miratojnë vendimin duke e rikthyer një kopje të nënshkruar të vendimit me shkrim Presidentit në selinë ligjore të Shoqatës. Anëtari që kundërshton këtë vendim do ta shprehë kundërshtimin ndaj vendimit në formë të shkruar dhe do e rikthejë atë tek Presidenti në selinë ligjore të Shoqatës.

19.6. Anëtarët e Bordit që e kanë të pamundur të marrin pjesë në një mbledhje të Bordit të thirrur në mënyrë të rregullt do njoftojnë me shkrim për mungesën e tyre dhe asyet për këtë mungesë dhe do e dërgojnë te Presidenti përpara zhvillimit të kësaj mbledhje të Bordit. Nëse Anëtari mungon rregullisht tre here në takime të njëpasnjëshme të planifikuara për arsye që Bordi i konsideron të papërshtatshme, ai/ajo humb mandatin e anëtarit të Bordit.

NENI 20

- 20.1. Shoqata kur e konsideron të nevojshme mund të kryejë veprimtari ekonomike për realizimin e objektivave dhe veprimtarive të saj deri në kufirin e parashikuar në Nenin 36, të Ligjit numer 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”.
- 20.2. Është e ndaluar shpërndarja e fitimeve apo përfitimeve nga të ardhurat e Shoqatës dhe përfitimet për anëtarët e Shoqatës, anëtarët e Bordit apo persona të tjerë siç është parashikuar në këtë Statut, përveç për pagat, shpërblimet dhe kompensimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës apo kontrata që ka lidhur Shoqata për marrjen e shërbimeve.

NENI 21 - LLOGARITË

- 21.1. Bordi do të krijojë dhe do të mbajë dy llogari bankare kryesore, një “Llogari Kryesore” dhe një “Llogari Operimesh” dhe veprimet do të kryhen si vijon:
 - a. Të gjithë kuotizacionet vjetore të anëtarësisë dhe kontribute të tjera për Shoqatën do të depozitohen në “Llogarinë Kryesore”;
 - b. “Llogaria e Operimeve” do të urdhërohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe do të përdoret për të mbuluar shpenzimet e përditshme operative të Shoqatës dhe do të financohet nga transfertat mujore të “Llogarisë Kryesore”;
 - c. “Llogaria Kryesore” do të përdoret vetëm për financimin e “Llogarisë së Operimeve”;
 - d. Sekretari i Përgjithshëm do të miratojë transferimet nga “Llogaria Kryesore” tek “Llogaria e Operimeve”, dhe shuma e transferuar nuk do të tejkalojë shumën e miratuar më parë dhe të përcaktuar në buxhet në total për çdo muaj pa miratimin e Bordit;
 - e. Bordi Drejtues do të miratojë vendimet përkatëse në lidhje me limitin e shumave për tërheqje dhe/apo transferime nga “Llogaria e Operimeve” mbi të cilat kërkohet autorizim i veçantë nga Presidenti i shoqatës apo në mungesë të tij/saj nga Zëvendës Presidenti. Për kryerjen e një veprimi të tillë, autorizimi do të përmend shumën specifike që do të përdoret në transaksionin bankar.
- 21.2. Bordi do të ketë të drejtën të mund të hap llogari tjetër bankare që sipas mendimit të Drejtorit Ekzekutiv apo Presidentit, do të mbështesë dhe lehtësojë operimet e Shoqatës.
- 21.3. Drejtori Ekzekutiv duhet të njoftojë menjëherë Bordin për çdo shqetësim ai/ajo mund të kenë në lidhje me fondet e tërhequra nga çdo llogari e Shoqatës. Ai/ajo do të sugjerojnë veprime që mund të ndërmerren për riparimin e situatës nëse ketë këto

shqetësime rezultojnë të jenë të vërteta.

- 21.4. Viti financiar i Shoqatës është nga 1 Janar deri në 31 Dhjetor të çdo viti.
- 21.5. Buxheti përfundimtar duhet të reflektojë qartësisht, për kapituj të veçantë , menaxhimin ekonomik dhe financiar të Shoqatës. Buxheti duhet të reflektojë qartësisht, për kapituj të veçantë të ndarë në bazë të menaxhimit të shkuar dhe zhvillimin e mundshëm të situatës, zhvillime të mundshme operative e financiare për vitin e ardhshëm kalendarik. Buxheti i rishikuar dhe i miratuar nga Bordi Drejtues mbi baza të skemave të përgatitura nga Drejtori Ekzekutiv, do të dorëzohen për miratim tek Asambleja e Përgjithshme jo më vonë se 30 Prill të çdo viti.

NENI 22

- 21.6. Vula zyrtare e Shoqatës dhe/apo vulat do të jenë të kufizuara vetëm për qëllime të aktivitetit. Përdorimi i tyre do të përcaktohet me një vendim të posaçëm të Bordit Drejtues.
- 21.7. Gjuha zyrtare e përdorur në korrespondencën e Shoqatës do të jetë gjuha Shqipe.

NENI 23 - SHPËRNDARJA

- 21.8. Shoqata mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Ky vendim duhet marrë me shumicë të cilësuar të $\frac{3}{4}$ të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote në takim.
- 21.9. Në rast shpërndarjeje, asetet e Shoqatës do të përdoren të mbulojnë çdo detyrim të papaguar. Çdo aset i mbetur pas kësaj do të shpërndahet si është vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

NENI 24 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ky Statut do të hyjë në fuqi ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e Shoqatës ka marrë formë të prerë.

Të gjitha çështjet të cilat nuk janë të parashikuara shprehimisht në këtë Statut do të rregullohen në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7850, datë 27.09.1994 “Kodi Civil Shqiptar”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jo-Fitimprurëse”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e një Organiate Jo-Fitimprurëse”.

Ky Statut është hartuar në disa kopje identike, në gjuhën Shqipe.

THEMELUESIT E SHOQATËS

- 1. Luan Leka - EHWshpk** _____
- 2. Donika Mici – Donianna shpk** _____
- 3. Nikolin Jaka – AgroAl International shpk** _____
- 4. Bardhyl Balteza – Edipack sha** _____
- 5. Ylli Braka – Klodi sha** _____
- 6. Luan Muca – DAST sha** _____
- 7. Stefan Pinguli – Stefani & Co sha** _____
- 8. Vullnet Haka – Everest IE shpk** _____
- 9. Ibrahim Myftaraj – GBE Herbs shpk** _____
- 10. Lumir Osoja – Center Shqiptare shpk** _____
- 11. Edmond Ziso – Aquila Group shpk** _____